

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 13.04.2017]

Për: Operatorin ekonomik "Besta" sh.p.k me NIPT J62903182B

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur" me objekt : "Rikonstruksioni i rrugëve 2; 3; 4 dhe paralele në Golem, Kavajë".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksioni i rrugëve 2; 3; 4 dhe paralele në Golem, Kavajë".

Kohëzgjatja: 8 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 80.401.816 (tetëdhjetë milion e katërqind e një mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 50.000.000 (pesëdhjetë milion) leke pa tvsh. Pjesa e mbetur eshte parashikuar per vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Date 06.03.2017.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	A.L-ASFALT & VICTORIA INVEST	47,165,698
2	CAUSHI	48,258,951
3	B-93	50,717,449
4	MELA. & ALBSHPRESA	56,000,000
5	BESTA	56,028,756
6	"SHKELQIMI 07" & SHENDELLI	56,358,407
7	BE - IS SH.P.K & AURORA	57,943,443
8	HASTOÇI	59,753,792
9	EUROTEOREMA PEQIN	60,000,000
10	S I R E T A 2F	61,111,111
11	COMPANY RIVIERA 2008	61,796,036
12	KUPA & KOLA INVEST	62,214,781

13	DELIA GROUP & MANETSI	63,068,979
14	Edonil Konstruktion	63,199,266
15	G.P.G. COMPANY	69,049,810
16	BOSHNJAKU. B	74,172,426
17	ARIFAJ	75,063,197
18	EURONDERTIM M.K.	77,736,642
19	VELLEZERIT HYSA	79,023,258
20	VARAKU E	NUK KA OFERTE

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Shoqeria “Caushi” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Kukes, Memaliaj, Peqin, Berat, Vrrine. Per keto objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk e ka regjistruar ne QKB. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje mjeti autobetoniere, me targe AA145CZ, sipas kontrates se qerese lidhur me nr 1558 Rep dhe nr 263/1 Kol, te dates 19.04.2016, lidhur para noteres Ermira Rizaj. Te njejtin mjet shoqeria “Ferro Beton” shpk ja ka dhene me qera shoqerise “Garden Line” shpk” shpk me kontraten me nr 1176 Rep dhe nr 254 Kol lidhur me shoqerine “Ferro Beton” shpk ne daten 27.02.2017 para noteres Xhevahire Brahja. Kontrata eshte fiktive me qellim plotesimin e kerkesave per kualifikim.

2. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Mela” shpk (80%) dhe “Albshpresa” shpk (20%) per arsye se:

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime hidroteknike, per kryerjen e te cilave ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier topograf, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime hidroteknike dhe punime rrugore, per kryerjen e te cilave ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier elektrik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime elektrike, per kryerjen e te cilave ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi ka marre persiper punime shtresash rrugore dhe nuk ka piken e licenses NS18 (punime topogjeodezike). Po ashtu ka marre persiper punime elektrike dhe nuk ka piken e licenses NP 11.

3. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Shkelqimi 07” shpk (70%) dhe “Shendelli” shpk (30%) per arsye se:

Shoqeria “Shkelqimi 07” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Kavaje, Vlore, Toshkez, Greshice. Per keto objekte nuk ka paguar detyrimet vendore.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

4. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Be - Is” shpk (62.5%), dhe “Aurora Konstruksion” shpk (37.5%) per arsye se:

Shoqeria “Be-Is” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Durres, Librazhd dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

5. Shoqeria “Euroteorema Peqin” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Milot – Lezhe - Rreshen nga viti 2011 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

6. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Sireta 2F” shpk (82.75%) dhe “Artyka II” shpk (17.25%) per arsye se:

Shoqeria “Sireta 2F” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Bashkine Maliq nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Artyka II” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Bashkine Liqenas nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

7. Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk per arsye se:

Referuar deklarates se puneve ne proces rezulton se shoqeria “Company Riviera 2008” shpk ka ne proces pune me nje vlere te pergjithshme prej 229.425.750 leke pa tvsh. Keto pune konsistojne ne rivitalizime urbane dhe rikonstruksione rruges. Per kontraten qe prokurohet shoqerise “Company Riviera 2008” shpk i takon te kryeje nje volum punimesh prej 82.575.000 lekesh pa tvsh. Vlera totale e punimeve qe duhet te kryeje shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nese shpallet fituese e kontrates qe shqyrtohet eshte 309.827.566 leke, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4C e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 100.000.000 leke. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

8. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Delia Group” shpk (27%) dhe “Mane TCI” shpk (73%) per arsye se:

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje kamioncine.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ka paraqitur formularin e deklarimit te mjeteve.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Infrastruktura rrugore dhe rrjeti i jashtem inxhinierik ne kompleksin Rolling Hills”. Punimet kane filluar ne vitin 2009. Per kete objekt mungon formualri i vleresimit i percaktuar ne kerkesat per kualifikim. Vlera totale e objektit (referuar aktit te kolaudimit) eshte 1.284.225.319 leke me tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur komisioni verejti se punimet e kryera jane kryesisht punime ndertimore (punime betoni etj) dhe nuk kane ngjashmeri me punimet rrugore qe prokurohen me proceduren aktuale.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje inxhinier ndertimi dhe nje inxhinier ndertimi i profilit transport.

9. Bashkimi i perkohshem i Operatoreve Ekonomike “Edonil Konstruksion” shpk (30%) dhe “Bahas” shpk (70%) per arsye se:

Ne marreveshjen e bashkepunimit ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne perputhje me VKM.

10. Shoqeria “GPG” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Korce nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

11. Shoqeria “Boshnjaku B” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

12. Shoqeria “Eurondertim MK” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi nuk disponon piken e licenses N.P – 11. A (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë).

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

13. Shoqeria “Varaku E” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.**14. Shoqeria “B-93” shpk per arsye se ka paraqitur oferte anomalisht te ulet dhe nuk ka mundur te argumentoje kete oferte.**

15. Shoqeria “Al Asphalt” shpk per arsye se ka paraqitur oferte anomalisht te ulet dhe nuk ka paraqitur asnje argumentim per kete oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Besta” sh.p.k (NIPT J62903182B) se oferta e paraqitur, me vlerë 56.028.756 (pesedhjetë e gjashtë milion e njezet e tete mije e shtateqind e pesedhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania
- Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)
- Fax: 00355 4 2 234 885

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **31.03.2017**.

Per vleresimin ne daten 05.04.2017 paraqiti ankese shoqeria “Sireta 2F” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 06.04.2017. Ne daten 12.04.2017 perfaqesuesi i shoqerise “Sireta 2F” shpk paraqiti nje shkrese ku deklaroi terheqjen nga ankimi.